



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo



**Komuna e Vitisë**  
Opstina Vitina-Municipality of Vitina

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prillogjen Më Drita **18.08.2022**

Nr. i organit / Org. broj	Numri/Droji	Shifra e Prilog	Vlera Vrednos
02	370/03-810		

ZYRA E PROKURIMIT

## KONTRATË PËR PUNË

Nr. <sup>1</sup> i prokurimit	657-20-3446-5-2-1
Nr i brendshëm	VI657-20-039-521

TITULLI I KONTRATËS : **Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndrrim në Çerdhe të fëmijve në fsh. Çifllak**

E LIDHUR NË MES TË

Operatori ekonomik	Autoriteti kontraktues
<b>Grup i Op. Ek. AVAG GROUP SH.P.K. &amp; BARDHI NDERTIM SH.P.K. &amp; SINANI ING SH.P.K., Prishtinë,</b> Përfaqësuar nga:	<b>Komuna e Vitisë</b>  Përfaqësuar nga:
Skender Zuka , drejtor	Fadil ABAZI, menaxher i prokurimit

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivate të prokurimit

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndrrim në Çerdhe të fëmijve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: VI657-20-039-521

PJESA B: KONTRATA & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA

**Komuna e Vitisë**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njënën anë; dhe

**Grup i Operatorëve Ek. AVAG GROUP SH.P.K.& BARDHI NDERTIM SH.P.K. & SINANI SH.P.K.**, , **Prishtinë**, në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë: Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të fëmijve në fsh. Çifllak

numër identifikues: VI657-20-3446-521

#### Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të fëmijve në fsh. Çifllak**
- 1.2 Fillimi i realizimit të kontratës: Kontraktori duhet të jetë i gatshëm për fillimin e punëve menjëherë gjegjësisht kur të merr urdhër për fillimin e punëve nga Autoriteti Kontraktues.

#### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **61 230,50 €**

*Me fjalë: Gjashtdhjetë një mijë e dyqind e tridhjetë Euro / 50Centi*

- 2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.
- 2.3 Kjo kontratë është sipas shpenzimeve buxhetore në KASH, pagesat do të bëhen sipas situacioneve të punëve të kryera, pasi buxheti mundëson përfundimin e këtij projekti.
- 2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

#### Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në rast të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të fëmijve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: VI657-20-039-521

## Neni 4

## Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [shqipe]<sup>2</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin:		Për Autoritetin Kontraktues:	
Emri:	<b>Skender Zuka</b>	Emri:	<b>Fadil ABAZI</b>
Pozita:	<b>Me autorizim</b>	Pozita:	<b>Menaxher i Prokurimit</b>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<b>17/08/2020</b>	Data:	<b>17/08/2020</b>
Vula:		Vula:	

## PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërim në Çerdhe të famijve në fsh. Çifllak/Numër identifikues: V1657-20-039-521

inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shumën që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe inxhinierët tjerë që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cilin është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfilim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguheshin ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Menaxheri i Projektit. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Menaxherit të Projektit. Menaxheri i Projektit do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njezh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të fëmijëve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: VI657-20-039-521

ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

## Neni 5 Personeli

5.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

## Neni 6 Obligimet e Kontraktuesit

6.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të ketij njoftimi.

6.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

6.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalojë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

6.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

6.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Neni 8.

6.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndër marr punë të ngjashme.

6.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

6.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: okskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastiit, objektet përreth, trafikun etj.

6.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

## Neni 7 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të femijve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: VI657-20-039-521

7.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekje, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

7.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

7.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

7.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

7.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrisë çmimin e shpërblimit nga fillimi i kontraktuesit.

## Neni 8 Programi

8.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

8.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

8.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

8.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

## Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

9.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

9.3 Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

9.4 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të sigurojë kontraktuesi, në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

9.5 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund të caktojnë kohën dhe vendin për ri-testim. Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit. Në qoftë se pas testimit, Menaxheri i Projektit konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuar, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të fëmijëve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: VI657-20-039-521

## Neni 10 Fillimi i punëve

10.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

10.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

## Neni 11 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

11.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 30;

11.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

11.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 11.2 Autoriteti Kontraktues do t'i lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyelohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

## Neni 12 Paralajmërim i hershëm

12.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vonë në kualitetin e punëve.

12.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

12.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

## Neni 13 Korrigjimi i defekteve

13.1 Menaxheri i Projektit do të njoftoj Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuese të defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuese të defekteve është përcaktuar në KVK. Periudhës garantuese e defekteve do të zgjatet deri sa të përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korrigjoj defektet brenda afatit kohor të specifikuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korrigjuar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës.

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të fëmijëve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: VI657-20-039-521

## Neni 14 Paramasa dhe Paralogaria

14.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

14.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

## Neni 15 Vërtetimet e pagesës

15.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë

15.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

15.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

15.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlera e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

15.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

## Neni 16 Pagesa

16.1 Pagesat do të bëhen në *Euro*.

16.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

16.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

16.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

## Neni 17 Shkaqet për kompensim

17.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të fëmijve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: VI657-20-039-521

- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

17.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

#### Neni 18 Tatimi

18.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

18.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

18.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

18.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

#### Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

#### Neni 20 Parapagimi

20.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë dhe nga një bankë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

20.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

20.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

#### Neni 21 Mbajtja e Parasë

21.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalohet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkaloj 10% e vlerës totale të kontratës origjinale.

21.2 Me lëshimin e Certifikatës mbi Përfundimin e Punëve nga ana e Menaxherit të Projektit, shuma totale e ndaluar do të paguhet Kontraktuesit kur të kalojë periudha garantuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Kontraktuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korrigjuar. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

#### Neni 22 Siguria e ekzekutimit

22.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të fëmijëve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: VI657-20-039-521

ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e moszekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

22.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

22.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

#### Neni 23 Kostoja e Riparimeve

23.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

#### Neni 24 Përfundimet dhe Certifikata e pranimit të punëve

24.1 Pasi që kryesisht të jete përfunduar të gjitha punët dhe të kenë kaluar të gjitha Testet e kompletimit të punëve të përshkuara në kontrate, kontraktuesi mund të njoftoj Menaxherin e Projektit me një njoftim me shkrim se do të kryej të gjitha punët e diskutueshme gjatë Periudhës Garantuere të defekteve. Ky njoftim dhe ky zotim se të gjitha punët e diskutueshme do të kompletohen gjatë Periudhës garantuere për defekte do të merren si kërkesë e Kontraktuesit për Menaxherin e Projektit për lëshim të Certifikatës-mbi-Pranim të punëve.

24.2 Brenda 21 ditëve të pranimit të kësaj kërkesë Menaxheri i Projektit ose do të lëshoj Certifikatën e pranimit të punëve, duke cekur datën, sipas mendimit të tij, e përfundimit të punëve ose do të jap instruksione për punët të cilat duhet të kryhen nga ana e Kontraktuesit para lëshimit të kësaj Certifikate.

24.3 Kontraktuesi, me pëlqimin e Menaxherit të Projektit, ka të drejtën e pranimit të kësaj Certifikate brenda 21 ditëve të kompletimit të punëve dhe të përmirësimit të defekteve të cekura.

24.4 Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër vend punimin dhe punët brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së përfundimit nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 25 Llogaritja përfundimtare

25.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët të cilat duhen t'i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës para përfundimit të Periudhës garantuere për defekte. Menaxheri i projektit do të lëshoj Certifikatën e periudhës garantuere të defekteve dhe do të certifikoj cilëndo pagese finale e cila duhet t'i paguhet Kontraktuesit brenda 15 ditëve pas pranimit të llogarisë nga ana e kontraktuesit nëse nuk vëren të meta. Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh do të paraqesë një plan që paraqet fushëveprimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme. Nëse llogaria përfundimtare edhe pas ri-dorëzimit akoma mbetet e pakënaqshme, Menaxheri i Projektit do të vendos mbi shumën e cila do t'i paguhet Kontraktuesit dhe do të lëshoj certifikatën mbi pagesën.

#### Neni 26 Shkëputja e kontratës

26.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

26.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përkrahur nga kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të Fëmijëve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: VI657-20-039-521

- d. Paguesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonchet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dënimeve të likuiduara mund të paguhet.

26.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 26.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

26.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

26.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

## Neni 27 Paguesa pas shkëputjes së kontratës

27.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

27.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

## Neni 28 Prona

28.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

## Neni 29 Lirimi nga Ekzekutimi

29.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i lufës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## Neni 30 Forca madhore

30.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

30.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të fëmijëve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: V1657-20-039-521

duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentim/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të fëmijëve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: V1657-20-039-521

	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <i>[Gjuha Shqipe]</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje; (e) Janë të parapara në policen e sigurimeve të dorëzura nga OE.
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <i>Planit dinamik të dorëzuar në ofertën e tenderit.</i>
Menaxheri i kontratës	8.2	Inxh.d. Diana Avdyli 044 710 894
Inspektimi dhe testimi	9.1	Menaxheri i projektit, udhëheq dhe mbikqyr me punimet e projektit dhe përcjell kualitetin dhe kërkon atestet e cilësisë sipas kontratës, dhe përcjell situacionet për pagesë, sipas dinamikës së projektit dhe Planit të menaxhimit të kontratës.
Specifikimet		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kualiteti të jetë konform standardeve, të përgjigjet ISO standardeve për kualitet</li> <li>• Garancioni i kualitetit të jetë 12+1 muaj pas pranimit teknik</li> <li>• Atestet duhet të sjellën për të gjitha materialet e kërkuara nga Mbikëqyrja</li> <li>• Testimi dhe marrja e kampioneve do të jetë i përcaktuar nga mbikëqyrja</li> <li>• Dimensionet, sasia, trashësia dhe cilësia të jenë konform paramasës së tenderit</li> <li>• Të vendoset panoja me shënime për punekryesin dhe investitorin në dimension prej min.120x150 cm</li> </ul>
	10.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë sipas <b>Planit Dinamik</b> , dhe kushteve në <b>Planin e menaxhimit të kontratës</b> Fillon në ditën e nënshkrimit dhe përfundon me datë 31.12.2020

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërim në Çerdhe të fëmijëve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: VI657-20-039-521

		Kontrata sipas planifikimit është dyvjeqare, bazuar ne Kornizën buxhetore te shpenzimeve
Pagesat		Pagesat behen sipas pranimit te situacioneve mbi punet e kryera dhe pranimit te Raportit nga Mbikëqyrja gjegj. Menaxheri i kontrates. Sipas Memorandumin e MASHTI DHE Komunes se Vitise, Te dates 29.05.2020, numer 043, Obligimet financiare jane te MASHTI 60,000.00 €, dhe 6,000.00 NGA Komuna
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [ 3 ] ditë pas marrjes së fteses urdhrit nga AK
Dëmet e likuiduara	19.1	Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë/realizoj ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, punëdhënësi, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është e Çmimit final të Kontratës.
Dëmet	20.1	Infrastruktura ekzistuese nuk guxon te demtohet, ne rast se po, duhet te kthehet ne gjendjen e meparshme
Mbajtja e Parasë	21.1	<i>Shuma 6,123.00 €</i>
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e vlerës së kontratës ose ne shumen prej
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është [shëno përqindjen].
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	Palet do te bejne te gjitha perpjekjet per te zgjidhur ne menyre miqsore te gjitha mosmarveshjet qe mund te ndodhin ne mes tyre sapo te shfaqet ndonje mosmarveshje , palet do te lajmrojne njeratjetren me shkrim per poziten e tyre ne mosmarveshje dhe per ndonje zgjdhje qe ata konsiderojne se eshte e mundhme

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndërrim në Çerdhe të fëmijve në fsh. Çifllak;Numër identifikues: V1657-20-039-521

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike në pajtim me ligjin në Kosovë.</b>
--	------	--

Titulli:

Titulli Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndritim në Çerdhe të fëmijve në fsh. Çifllak; Numër identifikues: VI057-20-039-521

PARAMASA PER RENOVIMIN E QERDHES SE FËMIJVE NË QIFLLAK					
1 PUNËT E DEMOLIMIT					
	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1.1	Demolimi i mureve ekzistuese për hapjen e dyerve , dhe hapësirave për tualete të reja sipas projektit dhe largimi i mbeturinave deri në vendin ku e cakton organi mbikqyrës.	m <sup>2</sup>	130.00	10.00 €	1,300.00 €
1.2	Demolimi i pllakave të keramikës në dysheme dhe mure te tualeteve , dhe largimi i mbeturinave deri në vendin ku e cakton organi mbikqyrës.	m <sup>2</sup>	96.50	5.00 €	482.50 €
1.3	Demolimi i mbulesës ekzistuese të kulmit dhe largimi i mbeturinave deri në vendin ku e cakton organi mbikqyrës.	m <sup>2</sup>	680.00	8.00 €	5,440.00 €
1.4	Demolimi (grryerja) e suvatimit në pllafonet e shkollës dhe transporti deri në deponi e materialit	m <sup>2</sup>	400.00	5.00 €	2,000.00 €
Gjithësejt					9,222.50 €

2 PUNËT E NGJYROSJES DHE SUVATIMIT					
	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
2.1	Furnizimi me material dhe suvatimi me të gjitha shtresat i plafoneve të shkollës	m <sup>2</sup>	460.00	6	2,760.00 €
2.2	Pregaditja dhe pastrimi i mureve të brendëshme dhe pllafoneve për ngjyrosje	m <sup>2</sup>	1,200.00	1.5	1,800.00 €
2.3	furnizimi me material dhe gletimi i sipërfaqeve të plafonit me glet .	m <sup>2</sup>	460.00	1	460.00 €
2.4	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e pllafoneve dhe mureve të brendëshme me bazë dhe ngjyrë të prodhuesit Italian PANTEK apo të ngjashëm me dy shtresa,ngjyra caktohet në pajtueshmëri me investitorin dhe organin mbikqyrës.Ngjyrosja e mureve deri në lartësi 1.2 m bëhet me ngjyrë yndyrore.	m <sup>2</sup>	1,200.00	1.00 €	1,200.00 €
2.5	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve të jashtme me bazë dhe ngjyrë të prodhuesit Italian PANTEK apo të ngjashëm me dy shtresa,ngjyra caktohet në pajtueshmëri me investitorin dhe organin mbikqyrës.Ngjyrosja e mureve të bëhet me ngjyrë plastike - e rezistueshme ndaj ndikimeve atmosferike.	m <sup>2</sup>	360.00	2.00 €	720.00 €
Gjithësejt					6,940.00 €

3 PUNËT E KULMIT					
	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma

2.1	Furnizimi dhe Mbulimi i Kulmit me Lllamarin të Valëzuar - Plastifikuar ngjyrë të Kafhtë , ku kulmaret mbuloohen me lllamarin të njejt si rrafshet , por të parapregaditur për vendet konkrete që lidhja të jetë në Vijë. Këtu të Llogaritet të Gjitha punimet e Lllarines së Valzuar - Plastifikuar, përfshirë borëpritësat mveshja e oxhakëve. Në çmim të llogaritet edhe furnizimi me material dhe punimi i perimetrit të kurores së kulmit me profile nga Lllarina e Plastifikuar si dhe Ullukët horizontal dhe vertikal. si dhe punimi i strehëve me lllamarin të plastifikuar	m <sup>2</sup>	680.00	8.00 €	5,440.00 €
<b>Gjithësejt</b>					<b>5,440.00 €</b>

<b>4 PUNIMI I TUALETEVE TË REJA</b>					
<b>4.1 Punet e murosjes dhe suvatimit</b>					
	<b>Përshkrimi i pozicioneve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Shuma</b>
4.1.1	Furnizimi me material dhe murosja e mureve ndarëse nga bllokat e argjilës me material lidhës , në pjesët ku parashifet punimi dhe ndarja e tualeteve sipas projektit.	m <sup>3</sup>	11.50	40.00 €	460.00 €
4.1.2	Furnizimi me materia të gatshëm për suvatim MP10 ose të ngjajshëm i mureve ndarëse në tualetet e reja .	m <sup>2</sup>	115.00	7.00 €	805.00 €
4.1.3	Furnizimi dhe montimi i pllakave të keramikës në muret e tualeteve sipas projektit - forma dhe dimensionit i pllakave të vendoset sipas organit mbikqyrës	m <sup>2</sup>	115	17.00 €	1,955.00 €
4.1.4	Furnizimi dhe montimi i pllakave të keramikës në dyshemetë e tualeteve sipas projektit - forma dhe dimensionit i pllakave të vendoset sipas organit mbikqyrës	m <sup>2</sup>	38	12.00 €	456.00 €
4.1.5	Furnizimi dhe vendosja e dyerve të plastikës të kualitetit të lartë me profile 8.0 cm të cilat duhet të kenë hapje në dy anët , me dimensione 100x210 cm në objektin e emergjencës.	copë	1	300.00 €	300.00 €
4.1.6	Furnizimi dhe vendosja e dritares të plastikës të kualitetit të lartë me profile 8.0 cm të cilat duhet të kenë hapje në dy anët , me dimensione 120x80 cm në pjesën në mes kuzhinës dhe dhomës së shërbimit në formë sporteli me hapje në formë rrëshqitëse "shiber".	copë	1	130.00 €	130.00 €
4.1.7	Furnizimi dhe montimi i pllakave të keramikës në muret e kuzhinës dhe dhomës së shërbimeve në lartësi 1.80 m . Parashifet gjithësi adekuat , fugat dhe llajset, sipas projektit - forma dhe dimensionit i pllakave të vendoset sipas investitorit.	m <sup>2</sup>	42	15.00 €	630.00 €

4.1.8	Furnizimi dhe montimi i pllakave të keramikës në dyshemetë e kuzhinës dhe dhomës së shërbimeve . Parashifet ngjitesi adekuat , fugat dhe llajsnet, sipas projektit - forma dhe dimensionit i pllakave të vendoset sipas investitorit.	m <sup>2</sup>	51	15.00 €	765.00 €
				<b>totali =</b>	<b>5,501.00 €</b>
<b>4.2</b>	<b>UJËSJELLËSI</b>				
4.2.1	Të bëhet përgatitja e kanaleve nëpër pllakën e betonit për vendosjen e gypave të ujësjellësit në bazë të projektit . Po ashtu edhe hapja e kanaleve për furnizim me ujë nga ujësjellësi ekzistues.	total	1	700.00 €	700.00 €
4.2.2	Blerja ,transporti dhe montimi i gypit Giacominì me izolim me të gjitha pjesët e nevojshme të fittingjeve , kuti shpërndarëse , lidhëse , kthesa redukues kolektorë etj . (uji i ftohtë dhe uji i ngrohtë ).	total	1	800.00 €	800.00 €
				<b>totali =</b>	<b>1,500.00 €</b>
<b>4.3</b>	<b>KANALIZIMI</b>				
4.3.1	Të bëhet përgatitja e kanaleve nëpër pllakën e betonit për vendosjen e gypave të kanalizimit në bazë të projektit . Po ashtu edhe hapja e kanaleve për largimin e ujërave të kanalizimit dhe lidhja me rrjetin ekzistues (të parashifen edhe 3 shakta lidhëse ).	total	1	700.00 €	700.00 €
4.3.2	Blerja ,transporti dhe montimi i gypave të kanalizimit me të gjitha pjesët e nevojshme të lidhjeve , kthesa redukues kolektorë etj .	total	1	800.00 €	800.00 €
				<b>totali =</b>	<b>1,500.00 €</b>
<b>4.4</b>	<b>SANITARIA</b>				
4.4.1	Blerja dhe montimi i WC-ve guacave komplet me gjitha paisjet percjellëse.për tualete të fëmijëve.	copë	6	80.00	480.00 €
4.4.2	Blerja dhe montimi i lavamanit për fëmijë , komplet me gjitha paisjet përcjellëse dhe pasqyra.	copë	6	80.00	480.00 €
4.4.3	Blerja dhe montimi i WC-ve guacave komplet me gjitha paisjet percjellëse.për tualete të personelit .	copë	2	80.00	160.00 €
4.4.4	Blerja dhe montimi i lavamanit për tualete të personelit , komplet me gjitha paisjet përcjellëse dhe pasqyra.	copë	2	80.00	160.00 €
				<b>totali =</b>	<b>1,280.00 €</b>
				<b>Gjithësejt</b>	

REKAPITULIM I E TUALETEVE TE REJA		
4.1	Punet e murosjes dhe suvatimit	5,501.00 €
4.2	PUNËT E UJËSJELLËSIT	1,500.00 €
4.3	PUNËT E KANALIZIMIT	1,500.00 €
4.4	PUNET E SANITARISË	1,280.00 €
	<b>TOTAL</b>	<b>9,781.00 €</b>
<b>5</b>	<b>PUNIMET E NXEMJES QENDRORE</b>	

	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	Ç.NJËSI	TOTALI
5.1	thyerja e betonit dhe hapja e vrimave për montimin e gypave të ngrohjes qendrore .	komplet	1.00	500.00 €	500.00 €
5.2	Furnizimi dhe vendosja radiatorëve nëpër dhomat e fëmijëve (nga dy për dhomë ) , koridore , zyre , tualete me të gjitha pjesët lidhëse , fittingje etj.	komplet	1.00	1,300.00 €	1,300.00 €
5.3	Furnizimi dhe vendosja e kaldajës me kapacitet të mjaftueshëm për funksionim normal për ngrohje, sipas projektit me te gjitha pjesët përcjellëse.	komplet	1.0	1,500.00 €	1,500.00 €
				<b>Gjithsejt :</b>	<b>3,300.00 €</b>
<b>6 PUNËT E ZDRUKHTARISË</b>					
	<b>Përshkrimi i pozicioneve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Vlera</b>
	Furnizimi dhe montimi i dritareve dhe dyerve të plastikës sipas ISO ose DIN standardeve të prodhuesve "Trokall", "Rehau" etj. me dimensione të profilit 8x8cm dhe 8x10cm si dhe me pesë qelija në profil minimum dhe hapje si në skema. Dritaret të paisen me mekanizëm përkatës për hapje-mbyllje(kiper)si dhe kualitative. Çelçi duhet të jetë termoizolues d=4+16+4mm				
6.1	Dritare PVC- 60/80 cm	copë	8.00	100.00 €	800.00 €
6.2	Dyer PVC-80/200	copë	8.00	150.00 €	1,200.00 €
6.3	Dyer PVC-90/210	copë	4.00	160.00 €	640.00 €
7.3	Dritare PVC-240/160	copë	1.00	300.00 €	300.00 €
				<b>Gjithësejt</b>	<b>2,940.00 €</b>

<b>7 PUNËT E ELEKTRIKËS</b>					
	<b>Përshkrimi i pozicionit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Shuma</b>
7.1	Furnizimi dhe vendosja e instalimit elektrik , ndriqimit , dhe shuko priza . Materialet dhe punimet e instalimit dhe kyqjes në pjesët ku ka pas ndryshime (te tualetet dhe te kuzhina).	komplet	1.00	#####	1,200.00 €
				<b>Gjithësejt</b>	<b>1,200.00 €</b>
<b>8 PUNËT E RENOVIMIT NË PJESEN E KUZHINËS</b>					
	<b>Përshkrimi i pozicioneve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Vlera</b>
8.1	Furnizimi me material dhe punimi i murit të ri nga pllakat dhe profilet e knaufit me trashesi d=20 cm.Dy rende të profileve U si dhe me nga dy pllaka te knaufit nga të dy anët sipas prospekteve të ndërtimit të mureve të knaufit me të gjitha elementet përcjellëse,duke përfshirë gletimin dhe ngjyrosjen e murit nga të dy anët-final	m <sup>2</sup>	20.0	20.00 €	400.00 €
8.2	Furnizimi dhe vendosja e derës së kuzhinës me material plastik dim 100 x200 cm sipas projektit.Në çmim të llogaritet edhe hapja e murit për vendosjen e derës dhe rregullimi i sipërfaqeve rreth kornizës së derës komplet pas vendosjes së derës	copë	1.0	180.00 €	180.00 €

8.3	Furnizimi dhe vendosja e dritarës rrëshqitëse me dimensione 140 x 140 cm nga materiali plastik,të dy krahët e dritares duhet të jenë rrëshqitëse.Në çmim të llogaritet edhe hapja e murit për vendosjen e dritares sipas projektit.	copë	1.0	250.00 €	250.00 €
8.4	Furnizimi dhe vendosja e pllakave të mermerit me dimensione 140x30x3cm-sollobanka nga ana e brendëshme dhe e jashtme e dritarës së vendosur të përforcuar me këndore metalike (këndoret me ngjyrë të bardhë).	copë	2.0	20.00 €	40.00 €
8.6	Furnizimi dhe vendosja e pllakave të keramikës në murin e kuzhinës duke llogaritur ngjitësin dhe fugat sipas projektit.Tipi,tekstura,ngjyra e keramikave zgjidhen nga investitori dh eorgani mbikqyrës.	m <sup>2</sup>	84.0	15.00 €	1,260.00 €
8.7	Furnizimi dhe vendosja e derës së kuzhinës me material plastik dim 90 x100 cm sipas projektit.Në çmim të llogaritet edhe hapja e murit për vendosjen e derës dhe rregullimi i sipërfaqeve rreth kornizës së derës komplet pas vendosjes së derës	copë	1.0	170.00 €	170.00 €
8.8	Furnizimi me material dhe përmirësimi i mureve të dëmtuara nga vendosja e kablove elektrike ,ujësjellësit dhe kanalizimit në hapsirën e kuzhinës dhe të njejtat të gletohen	komplet	1.0	200.00 €	200.00 €
8.9	Furnizimi dhe montimi i bojlerit 90 litra per ujë të ngroht me të gjitha elementet përcjellëse për kyqja në instalimin elektrik .	copë	1.0	200.00 €	200.00 €
8.1	Furnizimi dhe montimi i klimës me të gjitha elementet përcjellëse	copë	1.0	600.00 €	600.00 €
8.11	Furnizimi dhe vendosja e mjeteve të kuzhinës për përgaditjen e ushqimit për fëmijët dhe personat që janë në qerdhe ( stafin), shporeti elektrik me furrë , frigoriferit me vëllim te mjaftueshëm , frizi , shporetit nga plini , makines për larjen e enëve , lavabos për enë etj.	copë	1.0	1,400.00 €	1,400.00 €
8.12	Furnizimi dhe montimi i elemnteve të kuzhinës nga materiali dru në kombinim me mermer për vendosjen e elementeve të kuzhinës (raftave , tavolina e punës, vendi për vendosjen e frigoriferit etj). Me gjatësi 4.0 m	m'	4.0	400.00 €	1,600.00 €
8.13	Furnizimi dhe montimi i Ventilatorit të kuzhinës komplet	copë	1.0	100.00 €	100.00 €
8.14	Furnizimi i tavolinave për ushqim për fëmijët 4 copë për vendosjen e 6 fëmijëve dhe 25 karrigeve	total	1.0	1,000.00 €	1,000.00 €
<b>Gjithsejtë :</b>					<b>7,400.00 €</b>
<b>9</b>	<b>OBJEKTI NDIHMËS PËR VENDOSJEN E KALDASË.</b>				
	<b>Përshkrimi i pozicioneve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Vlera</b>

	Punimi i një objekti për vendosjen e kaldasë dhe materialeve për ngrohje qendrore me dimensione 400x450 cm .				
9.1	Hapja e themeleve me dimensione 40x40cm .	m <sup>3</sup>	1.5	40.00 €	60.00 €
9.2	Vendosja e zhavorit në bazen e themeleve dhe nën pllakën e cokullës	m <sup>3</sup>	3.2	20.00 €	64.00 €
9.3	Betonimi i themeleve të veçuara me dimensione 40x40 cm cokullës me dimensione 80x25 cm dhe pllakës BA mbi cokull me trashësi 15 cm .	m <sup>3</sup>	9.5	80.00 €	760.00 €
9.4	Betonimi i shtyllave me dimensione 25x25 cm dhe pllakës mbi përdhësë të objektit	m <sup>3</sup>	5.0	80.00 €	400.00 €
9.5	armimi i pozicioneve të themeleve , pllakave dhe shtyllave	kg	1460.0	0.70 €	1,022.00 €
9.6	Murosja e mureve të objektit të kaldasë me blloka të argjilës me trashësi 20 cm	m <sup>3</sup>	35.0	20.00 €	700.00 €
9.7	suvatimi i mureve të mbrendshme dhe pllafonit me suva te gatshme	m <sup>2</sup>	72.0	7.00 €	504.00 €
9.8	suvatimi i mureve të jashtme me suva te gatshme , në dy shtresa (Ilaq të gatshëm dhe abrib) si dhe ngjyrosja me ngjyrë adekuate .	m <sup>2</sup>	56.0	7.00 €	392.00 €
9.9	Furnizimi dhe vendosja e konstruksionit të kulmit me drunjë halore kat II-të , drrasa , hidroizolim-foli difuzive , dhe llamarinë të plastifikuar .	m <sup>2</sup>	18.0	30.00 €	540.00 €
9.1	Vendosja e derës metalike rezistente ndaj zjarrit me dimensione 100x210 cm .	copë	1.0	150.00 €	150.00 €
9.11	Vendosja e dritarës metalike me dimensione 120x140 cm	copë	1.0	200.00 €	200.00 €
9.12	Furnizimi dhe vendosja e instalimit elektrik (kablo , shuko priza, ndriqim etj , si dhe instalimi i nevojshëm për funksionimin e kaldasë.	total	1.0	150.00 €	150.00 €
9.13	Furnizimi dhe vendosja e ujës-jellësit dhe kanalizimit për një llavabo për funksionimin e kaldasë .	total	1.0	200.00 €	200.00 €
<b>Gjithsejtë :</b>					<b>5,142.00 €</b>

10 FURNIZIMI ME INVERTARË					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
10.1	Furnizimi me krevata për fjetje (krevati së bashku me dyshek të kualitetit të lartë , qarqafi , mbulesa dhe jastaku komplet) për fëmijë të moshës 1-5 vjeç .	copë	25.00	200.00 €	5,000.00 €
<b>Gjithësejt</b>					<b>5,000.00 €</b>
11 PUNIMET NE OBORRIN E QERDHES					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
11.1	Furnizimi dhe vendosja e dheut humusor per mbjelljen e luleve dekorative dhe gjelbërimit në pjesën e parkut t=20cm mbushje.	m <sup>3</sup>	220.00	5.00 €	1,100.00 €
11.2	Furnizimi dhe mbjellja e e barit per pjesen e gjelberimit.(Pjesa e djathtë para shkolles me bari kualitativ ndersa pjesa e majtë - nën pisha me bari i cili mbjellet nën hije.	m <sup>2</sup>	700.0	1.00 €	700.00 €

11.3	Furnizimi dhe vendosja e luleve dekorative ne pjesen e gjelberimit	copë	350.0	0.30 €	105.00 €
11.4	Furnizimi dhe mbjellja e pemëve dekorative të tipit "Pisha Abies", lartësia e pemës duhet të jetë prej 1.40 deri 1.70 m' dhe diametri 10 cm (Mbjellja e pishave të bëhet në perimetrin e rrethojës së shkollës - pjesa e mbrendshme).	copë	80.0	15.00 €	1,200.00 €
11.5	Furnizimi dhe mbjellja e pemëve dekorative të tipit "Catalpa", lartësia e pemës duhet të jetë prej 3.0 deri 4.0 m' dhe diametri 14 deri 16.0 cm.	copë	10.0	18.00 €	180.00 €
11.6	Furnizimi dhe mbjellja e pemëve dekorative të tipit "Kumbull e kuqe", lartësia e pemës duhet të jetë prej 2.50 m' dhe diametri 16 deri 20 cm	copë	10.00	18.00 €	180.00 €
				Gjithësejt	3,465.00 €

12. KËNDI I LOJËRAVE					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
10.1	Furnizimi me pajisje për lodra Për fëmijë, (topogan, hulaje, rreshqitëse, dhe të tjera sipas projektit).	copë	7.00	200.00 €	1,400.00 €
				Gjithësejt	1,400.00 €

REKAPITULIM I PUNIMEVE		
1	PUNËT E DEMOLIMIT	9,222.50 €
2	PUNËT E NGJYROSJES DHE SUVATIMIT	6,940.00 €
3	PUNËT E KULMIT	5,440.00 €
4	PUNËT E TUALETEVE TE REJA	9,781.00 €
5	PUNIMET PËR RREGULLIMIN E NXEMJES QËNDRORE NE	3,300.00 €
6	PUNET E ZDRUKHTARISË	2,940.00 €
7	PUNET E ELEKTRIKËS	1,200.00 €
8	PUNËT E RENOVIMIT TË KUZHINËS	7,400.00
9	OBJEKTI NDIHMËS PËR KALDA	5,142.00
10	FURNIZIMI ME INVERTARË	5,000.00
11	PUNIMET NE OBORRIN E QERDHES	3,465.00
12	KËNDI I LODRAVE	1,400.00
TOTALI I PËRGJITHSHËM		61,230.50 €

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	AVAG GROUP SHPK
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	MUHAMET ALIU
NËNSHKRIMI:	
DATA:	27.07.2020
VULA:	

Verifikuar!

1 [Signature]

2 [Signature]

3 [Signature]



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA OF KOSOVO  
 KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA  
 Pranuor - Prilijeno file/Dana 18.08.2020  
 Nr. l organit Nunci/Droj Shitja e Vlera  
 Org. broj Prilog Vrednos\*

	<p><b>Republika e Kosovës</b>  <b>Republika Kosova-Republic of Kosovo</b>  <b>Komuna e Vitisë</b>  <b>Opstina Vitina-Municipality of Vitina</b></p>	
<p>ZYRA E KRYETARIT          KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE</p>		

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008) dhe nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01- 013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

**V E N D I M**

**EMËRIMIN E MENAXHERIT PËR MBIKËQYRJEN E PUNIMEVE SIPAS KONTRATËS: : “Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndrrim në Çerdhe të fëmijëve në fsh. Çifllak”**  
**Nr. pr.VI657-20-039-521**

**I.**

**Xhelal Musa, CAKTOHET** menaxher i projektit për kontratën : **“Riparimi dhe adaptimi i shkollës fillore për shëndrrim në Çerdhe të fëmijëve në fsh. Çifllak”**

**II.**

Menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë:

- Menaxhimin e punëve të AK, të menaxhoj obligimet e AK sipas kontratës dhe të siguroj se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara,
- Të siguroj kontroll të kostove, cilësisë dhe sasisë dhe kohën e kryerjes se punimeve
- Të siguroj arttijen e qëllimit të kontratës, fushëveprimit, spicifikacionit dhe përgjegjësit e AK dhe punëkryesit
- Të dorëzoi Planin e menaxhimit të kontratës dhe monitoron kontratën nga nënshkrimi deri në skadimin e saj dhe kryerjen e pagesave
- Të pranoj punët e kryera nga kompania.

**III.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë dhe menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi.

**IV.**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Menaxherit,
2. Operatorit,
3. Zyrës së Prokurimit,
4. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË  
**Sokol Haliti**

